

2



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman
VENDIM**

Nr 1 Datë 14/04/2010

**“Për
miratimin e propozimit të Drejtorisë së Ujesjelles Kanalizimeve Berat për të
shpallur zonën përreth burimit të Bogoves si zonë e mbrojtjes së vecantë.**

Në mbështetje të nenëve 40, 41 dhe 42 të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” dhe të & III, pika 2.8.B të vendimit nr. 3, datë 19.07.2002 të KKKU “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Sekretariatit Teknik të KKKU, Këshillavë të Baseneve Ujëmbledhëse dhe Agjencive të Ujit”, Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin e propozimit të Drejtorisë së Ujesjelles Kanalizimeve Berat të të shpallur zonën përreth burimit të Bogoves si zonë e mbrojtjes së vecantë.
Zona të përcaktohet nga një grup ekspertësh të përfaqësuar nga :

- 1-Ministria e Burimeve Minerare të Ekonomisë dhe Energjitikës.
- 2-Ministria e Transporteve, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit.
- 3-Ministria e Mjedisit dhe Administrimit të Ujrave.
- 4-Ministrisë së Shëndetësisë.
- 5-Perfaqësues nga Drejtoria e U.K. Berat.
- 6-Perfaqësues nga Agjencia e Ujit Basenit Seman.

Ngarkohet AUB Seman për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËSI AUB
SEMAN
Ajen GRABOVA**



**KRYETARI I KBU
SEMAN
Bujar HASAJ**

